


01-1954



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitive të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-248766/22 dt. 14.11.2022, të kërkuarit / pronarit Ismet Gashi me investitor “Partner – Dervisholli ING”, sh.p.k., me seli në Prishtinë dhe përfaqësues Ekrem Qarolli nga Prishtina, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për kompleksin me ndërtesa shumëbanesore me afarizëm “Residio IV”, përkatësisht Lam.”A” me etazhitet 3B+S+P+8, Lam.”B” me etazhitet 3B+S+P+8 dhe Lam.”C” me etazhitet 4B+S+P+8, të ndërtuara në kuadër të Bllokut urban “A-25” të Planit Rregullues “Mati 1” në Prishtinë, në rr. “Bahri Fazliu” dhe “Venet Bajrami” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datë 23.01.2023, lëshon këtë:

## CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

**I. I LEJOHET** kërkuarit / pronarit Ismet Gashi me investitor “Partner – Dervisholli ING”, sh.p.k., me seli në Prishtinë dhe përfaqësues Ekrem Qarolli nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-248785/22 dt. 14.11.2022, përdorimi i kompleksit me ndërtesa shumëbanesore me afarizëm “Residio IV”, përkatësisht Lam.”A” me etazhitet 3B+S+P+8, Lam.”B” me etazhitet 3B+S+P+8 dhe Lam.”C” me etazhitet 4B+S+P+8, të ndërtuara sipas Vendimit për Lejimin e Ndërtimit, 05 Nr. 351-155942 dt.02.02.2017, dhe Vendimit për korrigjimin e gabimeve teknike të vendimit të lejeve të ndërtimit 05 Nr. 351-155942 dt.02.02.2017 të kompleksit “Residio IV” me ndërtesa shumëbanesore me afarizëm – lam.”A” me 3B+S+P+8, lam.”B” me 3B+S+P+8 dhe lam.”C” me 4B+S+P+8, dhe të vendimit të lejes së ndërtimit 05 Nr. 351-155933 dt.02.02.2017 të kompleksit “Residio V” me ndërtesa shumëbanesore me afarizëm – lam.”A” me 3B+P+7, lam.”B” me 3B+P+7 dhe lam.”C” me 3B+P+8, 05 Nr. 351/02-252305/22 dt.06.12.2022, në parcelen kadastrale nr.1580-0 ZK Matiçan, konkretisht në kuadër të bllokut urban “A-25” të Planit Rregullues “Mati 1” në Prishtinë.

**II.** Ndërtesat nga pika I. e këtij vendimi, ndodhen në rrugën “Bahri Fazliu” ku kanë dalje hyrjet me numrat: 138, 140, 142, 144, 146, 148, 150, 152, 154, 156, 158, 160, 162, 164 dhe 166, dhe në rrugën “Venet Bajrami” ku kanë dalje hyrjet me numrat: 168, 168/1, 168/2, 168/4, 170, 172 dhe 174 në Prishtinë, dhe të njejtat do të përdoren dhe shfrytëzohen sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

**III.** Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesave dhe njësive të tyre në evidencat e regjistrit kadastral.

**VI.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për Mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

### A r s y e t i m

Kërkuarit/ pronarit, Ismet Gashi me investitor “Partner – Dervisholli ING”, sh.p.k., me seli në Prishtinë dhe përfaqësues Ekrem Qarolli nga Prishtina, me kërkesën 05 Nr. 391/02-248785/22 dt. 14.11.2022, i janë drejtuar kësaj drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për kompleksin me ndërtesa shumëbanesore me afarizëm “Residio IV”, përkatësisht Lam.”A” me etazhitet 3B+S+P+8, Lam.”B” me etazhitet 3B+S+P+8 dhe Lam.”C” me etazhitet 4B+S+P+8, të ndërtuara në kuadër të bllokut urban “A-25”

Faqe 1 prej 2

të Planit Rregullues "Mati 1" në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parces kadastrale nr. 1580-0 ZK Matiçan, konkretisht në kuadër të bllokut urban "A-25" të Planit Rregullues "Mati 1" në Prishtinë, të ndërtuara sipas Vendimit për Lejimin e Ndërtimit, 05 Nr. 351-155942 dt.02.02.2017, dhe Vendimit për korrigjimin e gabimeve teknike të vendimit të lejeve të ndërtimit 05 Nr. 351-155942 dt.02.02.2017 të kompleksit "Residio V" me ndërtesa shumëbanesore me afarizëm – lam."A" me 3B+S+P+8, lam."B" me 3B+S+P+8 dhe lam."C" me 4B+S+P+8, dhe të vendimit të lejes së ndërtimit 05 Nr. 351-155933 dt.02.02.2017, të lëshuara nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektori i Ndërtimit, e Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Akt përcjellës", me referencë 09 Nr. 391/02-2160497/22 dt. 31.10.2022, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimet të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Yllka Rraci; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Besart Avdyli; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Jeton Canhasi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Besim Abrashi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Bujar Komoni; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga kompanija gjeodete e licensuar "GeoHorizont" shpk me nr. të licensës 54;

Drejtoria e Urbanizmit, pas pranimit të kësaj kërkesë dhe shqyrtimit të saj, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesat shumëbanesore me afarizëm mund të përdoren, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesat shumëbanesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.


**Udhëzimi juridik:** Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund t'i drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit, brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certifikatë. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

REPUBLIKA E KOSOVES

I dorëzohet: Kërkuesve/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,  
05 NR. 391/02-248766/22 DT. 23.01.2023**

Zyrtarja,  
Bahtije Vllasaliu  


U.D. Udhëheqëse e Sektorit,  
Nazife Krasniqi  


Drejtori,  
Arber Sadiki  
  